

REKOMANDIME

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

Grupi i Punës III (Zhvillimi Rural dhe Mbrotjtja eKonsumatorit) Sesioni 2, Tema: Bujqësia Organike

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, gjatë hartimit të objektivave duhet të ketë në fokus rritjen e sasisë dhe cilësisë së prodhimit organik. Përpos skemave mbështetëse të BE-së, është e nevojshme që strukturat shtetërore t'i japin prioritet financiar këtij sektori pasi prodhimi ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në jetesën e konsumatorëve.
- Nismat e ngjashme me “Oazin Ekologjik të Butrintit” të cilat ndihmojnë në zhvillimin e turizmit rural, agroturizmit, akuaturizmit, agropylltarisë duhet mbështeten pasi ndihmojnë në gjenerimin e të ardhurave në vend.
- Prodhimi organik rrit mundësinë për eksport në rajon dhe më gjerë duke mundësuar kështu rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare si dhe reduktimin e importit. Për këtë arsye, të gjitha certifikimet e nevojshme sipas standardeve të BE-së duhen zbatuar për ta lehtësuar këtë proces.
- Shqipëria duhet të vazhdojë të zbatojë nenin 95 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për modernizimin e sektorit të bujqësisë shqiptare duke forcuar sistemin institucional të prodhimit organik, reduktuar mbetjet dhe duke bërë përafrimin e legjislacionit përkatës me Acquis e BE.
- Sipas praktikës sllovaqe dhe asaj të BE-së duhet të përdoren vetëm fara dhe material mbjellës i prodhuar sipas sistemit organik. Në rastet kur nuk gjendet në treg në formë organike, mund të zëvendësohen me fara ose material i shtuar në rrugë vegjetative i prodhuar nëpërmjet bujqësisë konvencionale me kusht që të plotësohen kërkesat specifike dhe me autorizimin paraprak të dhënë nga autoriteti kompetent në vend.
- Shqipëria e ka përfshirë bujqësinë organike në Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021 – 2027 ku planifikohet hartimi, konsolidimi dhe zbatimi i një politike kombëtare për bujqësinë organike, e cila të lejojë sinergji me institucionet përkatëse dhe politikat e tjera zhvillimore përkatëse. Duhet të merren masat e nevojshme për zbatimin e kësaj strategjie.
- Duhet rritur ndërgjegjësimi publik dhe inkurajimi i tregut për produktet organike në të njëjtën

linjë dhe me Strategjinë e mësipërme ku parashikohet organizimi i një fushate promovuese për bujqësinë organike deri në vitin 2024.

- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) e cila është një organizëm kombëtar i akreditimit, i njohur nga qeveria për të vlerësuar në përputhje me standardet ndërkombëtare kompetencën teknike të organizmave të vlerësimit të konformitetit bën akreditimin e organizmave certifikues. Rekomandohet që të vazhdohet me ndjekjen e me standardeve ndërkombëtare të vendosura nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO).
- Laboratori i referencës për analizën e tokave (mbetjet toksike apo të lëndëve të tjera të papranueshme për prodhimin organik) duhet të pajiset me të gjitha kushtet teknike dhe stafin e kualifikuar për të dhënë rezultate të prekshme.